



SYLLABUS I LËNDËS “ E DREJTA SENDORE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Sendore
Programi:	Juridik i përgjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla), si dhe detaje të tjera do të caktohen në bashkëpunim me Fakultetin
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Muharrem Faiku
Të dhënat kontaktuese:	e-mail: muharem.faiku@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda E Drejta Sendore përfshinë shqyrtimin analitik të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore (Pronësisë, servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe të barrëve sendore). Ky kurs do përqendrohet në shqyrtimin e çështjeve themelore të drejtës së pronësisë si kuptimin (përmbajtjen) e pronësisë, fitimin (krijimin) e pronësisë, transaksionet (bartjen) me të drejtën e pronësisë, kufizimet e të drejtës së pronësisë dhe shuarjen e të drejtës së pronësisë. Gjithashtu do të shqyrtohen edhe të drejtat tjera sendore sepse domosdoshmërisht janë të lidhura me të drejtën e pronësisë, ndërsa shqyrtimi për aq sa është interesi i kursit që të drejtat pronësore të trajtohen në perspektivën e transaksioneve komerciale. Përmes këtij kursi synohet të merren njohurit themelore për të drejtën e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Qëllimi i kursit është ofrimi i njohurive ligjore dhe praktike për studentët në atë mënyrë se si të kuptohen më mirë</p> <ol style="list-style-type: none">1) dispozitat ligjore me të cilat rregullohet e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore dhe2) trajtimi profesional <p>- Si dhe në çfarë mënyre pjesëmarrësit në transaksione të pronësisë, i plotësojnë nevojat dhe qëllimet e tyre, mund të negociojnë, të bartin të drejtat dhe detyrimet, marrjen ose bartjen e rrezikut në transaksione pronësore, avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe drejtave tjera sendore, rëndësia ekonomike e pronës dhe e drejtave tjera sendore etj. Përmes këtij kursi synohet që studentët të përgatiten me njohuri të nevojshme për zbatimin e tyre në praktikë</p>

Rezultatet e të nxënit:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të kuptoj nocionet dhe institutet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore si: <ol style="list-style-type: none"> servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe barrëve sendore; Të jenë në gjendje për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore nga fusha e të drejtës pronësore; Të paraqes argumente verbale dhe me shkrim në çështjet e të drejtës së pronësisë në emër dhe për llogari të klientëve afarist; Të jenë në gjendje të kryen punë praktike në institucione të ndryshme të ndërlidhura me çështjet afariste: si gjykata komerciale, arbitrazhe, institucione financiare etj. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	40
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në terren	4	4	16
Kollokfiume, seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë	2	13	26
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	4	1	4
Projektet, prezantimet ,etj	10	1	10
Totali			200 orë (7 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjëratat do të zhvillohen duke respektuar format e avancuara për mësimdhënie. Do të zbatohet metodologjia interaktive, e cila përfshinë aktivitetet si nga ana e mësimdhënësit ashtu edhe të studentëve. Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive të studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për të drejtën sendore të Kosovës. Kjo do të mundësojë edhe zhvillimin e aftësive kritike për</p>		

	<p>studentët. Kursi do të organizohet përmes ligjëratave, seminareve dhe shqyrtimin e rasteve.</p> <p>Ligjëratat: mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme gojore e përcjell me power point, interaktive – bashkëbisedim me studentët, diskutim i çështjeve praktike</p> <p>Seminaret: çdo studentë duhet të punoj një punë kërkimore-shkencore që do të prezantohet përmes seminarit.</p> <p>Raste studimi-simulimi: gjatë kursit studentët do të kenë punë praktike të cilat do të jenë në formën e rasteve të studimit që mbahen në klasë. Studentët do të ngarkohen edhe me raste studimi të cilat duhet të punohen në si detyrë shtëpie dhe të sjellën te profesori në kohën e kërkuar. Rastet e studimit përbëhen nga formulime me shkrim të rasteve nga praktika dhe dhënia për detyrë studentëve për të zgjidhur rastin e tillë në pajtim me dispozitat ligjore. Simulimi i rasteve paraqet formë praktike përmes së cilës studentët aftësohen në ushtrime praktike duke simuluar raste dhe marrë rolin e palëve dhe organeve tjera në kontestet pronësore.</p>
<p>Metodologjia e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi intermediar i obliguar nga asistenti/ja vlerësohet me 20% (studenti duhet të arrije 10% e kaluashmeris se vlerësimit intermediar tek asistenti/ja, pasi që është kusht për të hyr tek provimi përfundimtar tek Profesori i lëndës).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrat ose angazhime tjera në ligjerata dhe ushtrime: 10%; • Vijimi i rregullt: 10%; • Provimi final: 60% (i obligueshëm për të gjithë studentët); <p>Total 100%</p>
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura primare:</p>	<p>1. Abdulla Aliu, “E drejta sendore (pronësia)”, Prishtinë, 2014.</p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Ejup Statovci, “Marrëdhëniet pronësoro-juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës”. Prishtinë, 1977, Ribotim 2009;</p> <p>- Ejup Statovci, “Pronësia, origjina dhe zhvillimi (studim komparativ)”. Prishtinë, 1983, Ribotim, 2009;</p> <p>- Elizabeth Cook (eds.), “Modern Studies in Property Law”, Vol. 4, Oxford, 2007;</p> <p>- Haxhi Gashi, “Mbrojtja e pronësisë private në rastet e shpronësimit: analizë e legjislacionit pozitiv në Kosovë në raport me standardet ndërkombëtare – praktikën e Gjykatës</p>

	<p>Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, Revista, E Drejta nr. 4, Prishtinë, 2009;</p> <p>- Francesco Galgano, “E drejta private 1 (pronësia)”, Luarasi, Tiranë, 2003.</p> <p>LIGJE:</p> <p>- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 5 57/2009 date 4 Gusht 2009.</p> <p>- Ligji nr 2002/5 mbi themelimin e regjistrimit të të drejtave në pronën e paluajtshme, i ndryshuar me Ligjin nr. 2003/13., me ndryshime në vitin 2011;</p> <p>- Ligji nr. 2003/25, për kadastrin, i ndryshuar me Ligjin nr. 02/L-96 dhe ndryshimet në vitin 2011;</p>
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje, prezantimi i lëndës	Hyrje prezantim i lëndës
<i>Java e dytë:</i>	Kuptimi i të drejtave sendore, në mënyrë të veçantë e drejta e pronësisë	Diskutim rreth kuptimit të drejtave sendore.
<i>Java e tretë:</i>	Bazat ligjore që rregullojnë të drejtat sendore Parimet e të drejtës sendore	Elaborim i parimeve të drejtës sendore, dhe burimet e të drejtës sendore.
<i>Java e katërt:</i>	Kuptimi i pronësisë, llojet e pronësisë	Diskutim përmes rastit praktik lidhur me kuptimin e të drejtës së pronësisë.
<i>Java e pestë:</i>	Transaksionet me pronësinë (fitimi dhe humbja e pronësisë)	Rast praktik, fitimi dhe humbja e të drejtës së pronësisë.
<i>Java e gjashtë:</i>	Vështrim i posaçëm i kontratave për shitblerjen të pronës	Vështrim i posaçëm i kontratave për shitblerjen të pronës, bazuar dhe në rast praktik.
<i>Java e shtatë:</i>	Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në paluajtshmeri Llojet e regjistrimit të drejtave pronësore	Sqarim i legjislacionit lidhur me Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në paluajtshmeri; Llojet e regjistrimit të drejtave pronësore.

<i>Java e tetë:</i>	E drejta e servituteve, nocioni i servituteve, parimet e servituteve, fitimi dhe shuarja e servituteve.	Diskutim rreth të drejtës së servituteve, nocioni, parimet, fitimi dhe shuarja të drejtës së servitutit.
<i>Java e nëntë:</i>	Llojet e servituteve - servitutet sendore - servitutet personale.	Diskutim rreth llojeve të servituteve sipas legjislacionit të tanishëm dhe të më parshëm.
<i>Java e dhjetë:</i>	Sigurimi i kërkesave të kreditorëve me pronë } llojet e mjeteve siguroese mbi prone.	Rast praktik lidhur me sigurimin e kërkesave të kreditorëve me pronë, llojet e mjeteve siguroese mbi prone.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	E Drejta e Pengu dhe e drejta e Hipotekës	Diskutim bazuar në legjislacionin lidhur me të drejtën e pengut dhe hipotekës.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	E Drejta e Barrës sendore	Rast praktik lidhur me të drejtën e barrës sendore.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Regjistrimi i të drejtave sendore në librat e paluajtshmërive	Diskutim rreth regjistrimit të drejtave sendore në librin e paluajtshmërive.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Përmbledhje, diskutime dhe evaluimi i kursit	Përmbledhje, diskutime dhe evaluimi i kursit.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përsëritje	Përsëritje
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<p>Studentët janë të obliguar që t'i përmbahen kriterëve të përcaktuara në syll abusin e lëndës dhe përgatitjen e provimit bazuar në literaturën bazë. Pjesëmarrja aktive / debati i studentëve në ligjëratë dhe në ushtrime do të vlerësohet.</p> <p>Studentët obligohen që t'i përmbahen politikave akademike dhe rregullave të mirësjelljes, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Vijimi i rregullt në ligjëratë dhe ushtrime; <input type="checkbox"/> Respektimi i orarit në ligjëratë dhe ushtrime; <input type="checkbox"/> Mos lëshimi i sallës gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve; <input type="checkbox"/> Ruajtja e integritetit akademik; <input type="checkbox"/> Ruajtja e disiplinës gjatë procesit mësimor; <input type="checkbox"/> Mospërdorimi i telefonave celular gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve (përveç në raste urgjente); <input type="checkbox"/> Respektimi i rregullave gjatë testeve dhe provimit (mos kopjimi, mos bisedimi me kolegë, etj.). <p>VËREJTJE: Ndryshimet eventuale mund t'i bëjë mësimdhënësi varësisht rrethanave sa i përket orarit të ligjëratave, caktimin e konsultimeve etj.</p>		

